



НАРОДНА БАНКА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Në mbështetje të nenit 48, paragrafi 1, pika 3 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/2010); nenit 5, paragrafi 6 të Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve në Marrëveshjet për Kreditë Konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 51/2011) dhe pikës, 16 paragrafi 2 të Vendimit për metodologjinë e llogaritjes së shkallës vjetore të shpenzimeve totale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 91/ 2011), guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi:

UDHËZIM

**për formën dhe përmbajtjen e formularit me informacione
parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore për kreditë konsumatore
(неофицијален пречистен текст¹)**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë udhëzim përcaktohet forma dhe përmbajtja e formularit me informacionet parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore për kreditë konsumatore.

2. Kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë, është i detyruar t'ia kumtojë konsumatorit të gjitha informacionet dhe të dhënat e nevojshme për lidhjen e kontratës për kredi konsumatore, para lidhjes së kontratës, duke paraqitur një formular për informacione parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore për kredi konsumatore (në tekstin e mëtejme: formulari).

3. Formulari përbëhet prej katër grupeve të informacioneve e të dhënave dhe dy kolonave.

Kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë nuk guxon të ndryshojë përmbajtjen e kolonës 1 të këtij formulari.

Sqarimet në kolonën numër 2 të formularit të dhënë në kllapa duhet të zëvendësohen me informacione dhe të dhëna të duhura nga kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë.

¹ Ky është një tekst i konsoliduar jozyrtar i Udhëzimit për formën dhe përmbajtjen e formularit me informacione parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore për kreditë konsumatore. Ky tekst i konsoliduar jozyrtar i Udhëzimit për formën dhe përmbajtjen e formularit me informacione parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore për kreditë konsumatore përbëhet nga: Udhëzimi për formën dhe përmbajtjen e formularit me informacione parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore për kreditë konsumatore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/2011 dhe Udhëzimi për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit për formën dhe përmbajtjen e formularit me të dhëna parakontraktore për kushtet e ofruara kreditore me kredi konsumatore. ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 134/2011).

Kur në kolonën numër 2 të këtij formulari, të dhëna në kllapa, duhet të zëvendësohen me informacione dhe të dhëna të duhura nga kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë:

- ta plotësojë këtë fushë, nëse informacioni është i njohur për të dhe është i duhur për kredinë,
- të japë një shpjegim që informacioni është i duhur për këtë kredi, por nuk e ka të njohur ose,
- të japë një shpjegim që informacioni nuk është i duhur për këtë kredi ose të fshijë rreshtin në të cilin është shënuar informacioni.”

4. Kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë, në aktet e tij të brendshme rregullon mënyrën se si do të sigurojë dëshmi që e ka dorëzuar formularin.

5. Formulari është dhënë në Shtojcën nr. 1, që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

II. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNIDMTARE

6. Ky udhëzim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërkaq do të fillojë të zbatohet më 1.10.2011.

**Guvernatori
Dimitar Bogov**

FORMULAR
PËR INFORMACIONE PARAKONTRAKTORE (TË DHËNA) PËR KUSHTET E
OFRUARA KREDITORE PËR KREDI KONSUMATORE

1. Të dhënat e kreditorit/ndërmjetësuesit kreditor

TË DHËNAT E KREDITORIT		
	Kolona 1	Kolona 2
1.	Emri i kreditorit	
2.	Adresa (adresa ku është i qasshëm kreditori)	
3.	Numri i telefonit*	
4.	Posta elektronike*	
5.	Faksi*	
6.	Faqja e internetit*	
TË DHËNAT E NDËRMJETËSUESIT KREDITOR (nëse është e zbatueshme)		
7.	Emri dhe mbiemri, përkatësisht emri i ndërmjetësuesit kreditor	
8.	Adresa (adresa ku është i qasshëm kreditori)	
9.	Numri i telefonit*	
10.	Posta elektronike*	
11.	Faksi*	
12.	Faqja e internetit*	

* Këto informacione nuk janë të detyrueshme për kreditorin/ndërmjetësuesin e kredisë

2. Të dhënat e produktit kreditor

	Kolona 1	Kolona 2
13.	Lloji i kredisë	<i>(Përshkrimi i llojit të kredisë)</i>
14.	Shuma e përgjithshme e kredisë, që përfshin:	<i>(Shuma duhet shënohet si shumë parash ose në mënyrë përshkruese, po qe se shuma varet nga shuma e një sasive tjetër)</i>

	- valuta në të cilën është shënuar kryegjëja ose me të cilën është lidhur kryegjëja, - shuma e përgjithshme në denarë, për kreditë e miratuara në denarë, - shuma e përgjithshme në valutë të huaj, për kreditë e miratuara në valutë të huaj - shuma e përgjithshme në denarë si kundërvlerë ndaj valutës së huaj, për kreditë me klauzolë valutore - kursi valutor sipas të cilit do të shlyhet kredisë (nëse është e zbatueshme) - kursi valutor sipas të cilit do të shlyhet kredisë (nëse është e zbatueshme). Shënohet shuma e kursit valutor ditën e plotësimit të formularit. Gjatë shlyerjes në mënyrë anuiteti të kredisë (në këste), shuma e kursit valutor për këstet e ndara mund të dallojë	<i>denarë/euro/dollarë/në denarë që lidhen me vlerën e euros ose një valute tjetër</i> <i>shuma në denarë</i> <i>shuma në valutë të huaj</i> <i>shuma në denarë dhe shuma në valutë të huaj</i> _____ (lloji i kursit valutor) që në ditën e plotësimit të formularit është: _____ _____ (lloji i kursit valutor) që në ditën e plotësimit të formularit është: _____ <i>Informacionet të cilat nuk janë të rëndësishme për kredinë, kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë mund t'i fshijë</i>
15.	Kushtet e shfrytëzimit të kredisë (si dhe kur do të shlyhen mjetet në bazë të kredisë)	<i>(Përshkrim se si dhe kur do të shlyhet kredisë)</i>
16.	Kohëzgjatja e kontratës për kredi	<i>(Afati i kontratës për kredi ose shënim që kontrata nuk ka afat)</i>
17.	Shuma e pagesave individuale dhe sipas rastit për llojin e kredisë - numri i kësteve, dinamika ose	<i>(Bashkëngjitni një shembull përfaqësues të shumës ose % të pagesave individuale dhe aty ku është</i>

	radha e mbërritjes së kësteve që duhen paguar.	<i>e përshtatshme për llojin e kredisë - numrin dhe dinamikën ose radhën e pagesave që konsumatori është i detyruar të bëjë, veçmas për kryegjënë dhe për interesin dhe tarifat)</i>
18.	Përshkrimi i mallit ose shërbimit dhe çmimi i tij në para, në rast kredisë në formën e pagesës së shtyrë për mallra ose shërbime të caktuara dhe kontratat e ndërlidhura për kredi (nëse është e zbatueshme)	<i>(Përshkrim i mallit/shërbimit) (Çmimi në tërësi)</i>
19.	Garancitë për kredinë, nëse është e zbatueshme (përshkrim i instrumentit të kolateralit që kërkohet nga konsumatori, për të lidhur një kontratë për kredi konsumatore)	<i>(Përshkrimi i instrumentit të kolateralit që kërkohet nga kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë dhe kushtet që të pranohet si garanci) (Nëse nuk kërkohet kolateral, shënohet që kredia nuk ka kolateral ose rreshti fshihet)</i>
20.	Detyrimi për të lidhur një marrëveshje për shërbime shtesë, nëse lidhja e një marrëveshjeje të këtillë është e detyrueshme për marrjen e kredisë ose për marrjen e kredisë në përputhje me kushtet e reklamimit	<i>(Lloji dhe përshkrimi i marrëveshjes për shërbimet shtesë që kërkohen për miratimin e kredisë) (Nëse shërbimet shtesë nuk janë të detyrueshme, kjo shënohet shkoqur ose rreshti fshihet)</i>
21.	Një llogari e veçantë për të regjistruar arkëtimet dhe shlyerjet në bazë të kredisë, nëse është e zbatueshme	<i>(Shënohet nëse është e detyrueshme çelja e një llogarie të veçantë në të cilën regjistrohen arkëtimet dhe shlyerjet në bazë të kredisë. Nëse çelja e llogarisë nuk është e detyrueshme, shënohet shkoqur ose rreshti fshihet)</i>

3. Të dhëna për shpenzimet e kredisë

	Kolona 1	Kolona 2
22.	Lloji i normës së interesit	<i>(Shënohet lloji i normës së interesit si më poshtë:</i>

	Kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë është i detyruar të informojë konsumatorin për llojin e normës së interesit dhe t'i shpjegojë se çfarë do të thotë kjo normë interesi, si dhe periudhat, kushtet dhe procedurën për ndryshimin e normës së interesit. Kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë është i detyruar të informojë konsumatorin nëse ndryshimi i normës së interesit kërkon pëlqimin e konsumatorit Nëse zbatohen norma të ndryshme interesi në periudha të ndryshme, i gjithë informacioni i shënuar jepet për secilën normë interesi	– <i>për një normë interesi fikse jepet shpjegimi se norma e interesit është e pandryshueshme</i> – <i>për një normë interesi të ndryshueshme, indeksi ose norma referencë e interesit në të cilën bazohet shuma e normës së interesit, periudhat, kushtet dhe procedura për ndryshimin e normës së ndryshueshme të interesit, si dhe marzhi që tarifton kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë dhe periudhat, kushtet dhe procedura për ndryshimin e tij. Nëse norma e interesit ndryshohet sipas kriterëve të tjera, jepet shpjegimi i procedurës së ndryshimit të saj.)</i> <i>(Pëlqimi i konsumatorit kërkohet/nuk kërkohet për të ndryshuar normën e interesit që tarifton kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë)</i>
23.	Shuma e normës së dakorduar të interesit (e shprehur në % në bazë vjetore) Nëse zbatohen norma të ndryshme interesi në periudha të ndryshme, i gjithë informacioni i shënuar jepet për secilën normë interesi	<i>(Përqindja e normës së dakorduar të interesit në bazë vjetore)</i> <i>(Nëse është e zbatueshme, shënohet çdo indeks ose normë referimi e normës fillestare të interesit dhe/ose e marzhit që tarifton kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë)</i>
24.	Shkalla vjetore e shpenzimeve të përgjithshme (SVT) e shprehur në % në vit, e paraqitur përmes një shembulli përfaqësues.	<i>(Shuma e SVT-së dhe shuma e përgjithshme që e paguan konsumatori)</i> <i>(Të jepet një shembull përfaqësues me supozimet për llogaritjen e SVT-së)</i>

	Gjatë llogaritjes së SVT-së, kreditori nuk përfshin shumën e shpenzimeve për të cilat nuk është në dijeni, por është i detyruar ta shënojë shkoqur Shuma e përgjithshme që e paguan konsumatori (shuma e kredisë dhe shpenzimet e përgjithshme për kredinë, përkatësisht të gjitha shpenzimet, duke përfshirë interesin, komisionet, tarifat e tjera, të cilat konsumatori duhet t'i paguajë gjatë miratimit dhe shlyerjes së rregullt të kredisë dhe të cilat janë të njohura për kreditorin, me përjashtim të shpenzimeve noteriale, por duke përfshirë shpenzimet e shërbimeve shtesë në lidhje me kontratën e kredisë, nëse përdorimi i shërbimeve shtesë është i detyrueshëm për miratimin e kredisë ose për miratimin e saj sipas kushteve të përcaktuara dhe nëse janë të njohura për kreditorin)	<i>së nenit 20 të Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve në Marrëveshjet për Kreditë Konsumatore)</i> <i>(Shpenzimet që nuk janë të njohura për kreditorin, përkatësisht ndërmjetësuesin kreditor dhe që nuk përfshihen në SVT dhe në shumën e përgjithshme që i paguan konsumatori, duhet të ndahen dhe shënohen shkoqur)</i>
25.	Shpenzimet për lidhjen e marrëveshjes për shërbime shtesë në lidhje me kontratën e kredisë konsumatore (siç është një marrëveshje sigurimi), nëse lidhja e një marrëveshjeje të tillë është e detyrueshme për marrjen e kredisë ose për marrjen e kredisë në përputhje me kushtet e reklamimit, nëse është e zbatueshme Nëse kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë nuk e ka të njohur shumën e këtyre shpenzimeve, duhet ta shënojë shkoqur. Kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë është i detyruar të shënojë nëse këto shpenzime janë përfshirë në SVT-në e llogaritur.	<i>(Shuma e shpenzimeve në bazë të marrëveshjes për shërbime shtesë në lidhje me kontratën e kredisë konsumatore, që janë të detyrueshme për miratimin e kredisë.</i> <i>Nëse nuk dihet shuma e saktë e shpenzimeve, shënohet shkoqur se shuma e shpenzimeve nuk dihet, por që është e detyrueshme të paguhet këto shpenzime.)</i> <i>(Nëse nuk është e detyrueshme që të paguajë shpenzime të këtilla, kjo shënohet shkoqur ose rreshti fshihet)</i>
26.		

	Shpenzimet e mbajtjes së një ose më shumë llogarive në të cilat regjistrohen arkëtimet dhe shlyerjet e pjesës së shfrytëzuar të kredisë, nëse është e zbatueshme. Nëse kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë nuk e ka të njohur shumën e këtyre shpenzimeve, duhet ta shënojë shkoqur. Kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë është i detyruar të shënojë nëse këto shpenzime janë përfshirë në SVT-në e llogaritur.	<i>(Shuma e shpenzimit për mbajtjen e llogarive.</i> <i>Nëse nuk dihet shuma e saktë e shpenzimeve, shënohet shkoqur se shuma e shpenzimeve nuk dihet, por që është e detyrueshme të paguhen këto shpenzime.)</i> <i>(Nëse nuk është e detyrueshme që të paguajë shpenzime të këtilla, kjo shënohet shkoqur ose rreshti fshihet)</i>
27.	Shpenzimet noteriale që i paguan konsumatori gjatë lidhjes së marrëveshjes, nëse është e zbatueshme. Nëse kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë nuk e ka të njohur shumën e këtyre shpenzimeve, duhet ta shënojë shkoqur. Këto shpenzime nuk janë përfshirë në SVT-në e llogaritur.	<i>(Përshkrimi dhe shuma e shpenzimeve noteriale.</i> <i>Nëse nuk dihet shuma e saktë e shpenzimeve, shënohet shkoqur se shuma e shpenzimeve nuk dihet, por që është e detyrueshme të paguhen këto shpenzime.)</i> <i>(Nëse nuk është e detyrueshme që të paguajë shpenzime të këtilla, kjo shënohet shkoqur ose rreshti fshihet)</i>
28.	Shpenzime të tjera që burojnë nga kontrata për kredi konsumatore dhe kushtet sipas të cilave këto shpenzime mund të ndryshojnë, nëse është e zbatueshme. Nëse kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë nuk e ka të njohur shumën e këtyre shpenzimeve, duhet ta shënojë shkoqur. Kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë është i detyruar të shënojë nëse këto shpenzime janë përfshirë në SVT-në e llogaritur	<i>(Përshkrimi dhe shuma e shpenzimeve të tjera dhe kushtet sipas të cilave këto shpenzime mund të ndryshojnë.</i> <i>Nëse nuk dihet shuma e saktë e shpenzimeve, shënohet shkoqur se shuma e shpenzimeve nuk dihet, por që është e detyrueshme të paguhen këto shpenzime.)</i> <i>(Nëse nuk është e detyrueshme që të paguajë shpenzime të këtilla, kjo shënohet shkoqur ose rreshti fshihet)</i>

29.	Norma e interesit e zbatueshme në rast të pagesave me vonesë, e shprehur në % në bazë vjetore, kushtet për ndryshimin e saj Paralajmërim për pasojat nga mosshlyerja e kësteve	<i>(Për humbjen e afatit të shlyerjes/shlyerje me vonesë, do t'ju tarifohen: _____</i> <i>Interesi ndëshkues, kushtet për ndryshimin e tij dhe nëse është e zbatueshme, shpenzimet për mospërbushjen e detyrimit të shlyerjes</i> <i>Lista e pasojave të mosshlyerjes së kësteve, që mund të përfshijë:</i> – <i>bazë ligjore të procedurës së përmbarimit të kërkesave</i> – <i>paralajmërim që mosshlyerja e kështit mund të rëndojë miratimin e kredive të reja...</i>
-----	--	---

4. Të tjera

30.	Ju keni të drejtë të tërhiqeni nga kontrata për kredi konsumatore brenda një periudhe të caktuar	<i>(Shënohet e drejta e konsumatorit për t'u tërhequr nga kontrata për kredi konsumatore dhe periudhën kohore gjatë së cilës mund të tërhiqet nga kontrata)</i>
31.	Ju keni të drejtën e shlyerjes së plotë ose të parakohshme të pjesshme të kredisë, ndërkaq kreditori/ndërmjetësuesi i kreditor është i detyruar t'jua kumtojë shumën e tarifës që duhet të paguani dhe mënyrën e përcaktimit të saj.	<i>(Shënohet shuma ose përqindja e tarifimit dhe mënyra e përcaktimit të saj)</i>
32.	Zgjidhja e kontratës së kredisë konsumatore (Kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë është i detyruar t'jua kumtojë të drejtën, procedurën dhe kushtet e zgjidhjes së kontratës për kredi konsumatore.)	<i>(Shënohet e drejta, procedura dhe kushtet e zgjidhjes së kontratës për kredi konsumatore)</i>
33.	Nëse pas kërkesës së paraqitur për kredi, e njëjta refuzohet për shkak të	

	informacionit të marrë nga bazat e të dhënave, ju keni të drejtën që kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë, t'ju informojë menjëherë dhe pa pagesë për këto informacione dhe për mënyrën se si i ka marrë këto informacione. Këto informacione jepen në të gjitha rastet, përveç rasteve kur dhënia e informacioneve është e ndaluar me ligj.	
34.	E drejta për një kopje falas të projektkontratës për kredi konsumatore Ju keni të drejtën që, me kërkesën tuaj, të merrni falas një kopje të projektkontratës për kredi konsumatore. Një projektkontratë nuk do të dorëzohet nëse kreditori/ndërmjetësuesi i kredisë nuk dëshiron të lidhë një kontratë kredie konsumatore në momentin e paraqitjes së kërkesës	
35.	Afati në të cilin kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë është i ngarkuar me informacionet parakontraktore, nëse është e zbatueshme <i>(Nëse është e zbatueshme, shënohet periudha ose datat e sakta në të cilat kreditori, përkatësisht ndërmjetësuesi i kredisë, është i ngarkuar me informacione parakontraktore që përmban ky formular</i> <i>Nëse nuk është e zbatueshme, kreditori, d.m.th., ndërmjetësuesi i kredisë mund të deklarojë se të dhënat dhe informacionet nga formulari mund të ndryshohen, për shembull bazuar në analizat e aftësisë kreditore të konsumatorit....)</i>	

Data e dorëzimit të formularit: _____